

# Mesazhet kryesore për specialistët e sëmundjeve infektive

---

## Detyrat

---

1. Detyrat tuaja lidhur me përmirësimin e përdorimit të antibiotikëve përfshijnë [31,56,68,71,83]:
  - a) Pjesëmarrjen në ekipin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve (kujdestaria e antibiotikëve), si një anëtar kyç i ekipit;
  - b) Bashkëpunimin me farmacistin e spitalit dhe mikrobiologun klinik për të zbatuar programin e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve;
  - c) Konsultimin me mjekët në spital dhe ofrimin e sugjerimeve për të siguruar cilësinë e përshkrimit të antibiotikëve;
  - d) Edukimin e mjekëve të spitalit se si të diagnostikojnë dhe trajtojnë infeksionet e zakonshme, si edhe për parimet e administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve;
  - e) Zbatimin e udhëzimeve të bazuara në dëshmi lidhur me përdorimin e antibiotikëve në spitale për infeksionet e zakonshme dhe për profilaksinë kirurgjikale;
  - f) Ndarjen e informacionit mbi profilin e mikrobiologjisë lokale dhe rezistencës ndaj antibiotikëve; dhe
  - g) Menaxhimin e formularit për përshkrimin e antibiotikut në spitalin tuaj (d.m.th., lista e ilaçeve të disponueshme për përshkruesit).

## Gjërat që mund t'i bëni ose në të cilat mund të bashkëpunoni

---

2. Mbështetni zhvillimin dhe zbatimin e një programi të administrimit të përgjegjshëm të antibiotikëve brenda organizatës suaj [69].
3. Promovoni udhëzimet lokale për menaxhimin e infeksioneve dhe përdorimin e antibiotikëve. Këto duhet të jenë lehtësisht të qasshme për të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor [56,69].
4. Kontrolloni që recetat e antibiotikëve të ndjekin protokollet e trajtimit me antibiotikë sipas udhëzimeve të bazuara në prova. Nëse shihni anëtarë të stafit në spital ose në mjediset e kujdesit shëndetësor që shkelin udhëzimet ose protokollet, pyetini pse po

e bëjnë këtë dhe ofroni mjete për të kuptuar se çfarë po bëjnë gabim [69]  
[konsensusi i ekspertëve].

5. Ofroni sugjerime dhe këshilla përshkruesve lidhur me vlerësimin diagnostik dhe trajtimin e sëmundjeve infektive [83].

6. Trajtoni rregullisht përshkruesit e antibiotikëve në spital në lidhje me përdorimin e kujdesshëm të antibiotikëve dhe merrni pjesë në takime për zbatimin e udhëzimeve të bazuara në prova për antibiotikët spitalorë [31,53].